



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 18 dhjetor 2017
Nr. ref.: RK 1170/17

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KIo6/17

Parashtrues

L. G. dhe pesë të tjerët

**Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës
Supreme të Kosovës, Rev. nr. 248/2016, të 25 tetorit 2016**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga L. G. dhe pesë fëmijët e saj nga Obiliqi (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës). Parashtruesit e kërkesës përfaqësohen nga Zaim Istrefi, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë Aktgjykimin [Rev. nr. 248/2016] e Gjykatës Supreme të Kosovës të 25 tetorit 2016, i cili u është dorëzuar atyre më 16 nëntor 2016.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Supreme, me të cilin pretendohet se janë shkelur të drejtat dhe liritë e parashtruesve të kërkesës, të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 50 [Të Drejtat e Fëmijës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).
4. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu kërkojnë që të mos zbulohet identiteti i tyre në procedurën në Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Gjykata), atë për arsye se konsiderojnë se *“ky rast është i natyrës së ndjeshme, pasi që ka të bëjë me pretendimet në lidhje me prindin i cili e ka humbur jetën tragjikisht”*.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuar] të Kushtetutës, në nenin 22 [Procedimi i Kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 29 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 25 janar 2017, parashtruesit e kërkesës dorëzuan kërkesën në Gjykatë.
7. Më 27 shkurt 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Ivan Čukalović.
8. Më 3 mars 2017, Gjykata i njoftoi parashtruesit e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe ia dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
9. Më 23 tetor 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Bashkëshorti dhe babai i parashtruesve të kërkesës respektivisht, ka vdekur më 8 maj 2005, si pasojë e një aksidenti në vendin e tij të punës. Ai ka qenë punëtor i Korporatës Energjetike të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KEK). Më 24 mars 2005, ai ka përjetuar fatkeqësi në vendin e tij të punës dhe me atë rast pësoi lëndime si pasojë e të cilave ka vdekur.

11. Në një datë të pacaktuar, parashtruesit e kërkesës paraqitën kërkesëpadi në Gjykatën Komunale në Prishtinë, përmes të cilës kanë kërkuar që e paditura (KEK) t'ua paguajë kompensimin në emër të *"dhimbjeve të pësuar shpirtërore"* për shkak të humbjes së bashkëshortit dhe babait respektivisht.
12. Më 27 dhjetor 2006, Gjykata Themelore në Prishtinë nxori Aktgjykimin [C. nr. 987/05], me të cilin aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesve të kërkesës. Gjykata Komunale vendosi që:

"Miratohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësve [...] dhe detyrohet e paditura - Korporata Energjetike e Kosovës në Prishtinë, që paditësve të përmendur në emër të kompensimit të dëmit për dhimbjet shpirtërore të përjetuara për shkak të vdekjes të afërmit bashkëshortit dhe babait, tani të ndjerit F. G., t'iu paguaj secilit nga 7.000 €, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 42.000 €."
13. E paditura [KEK] parashtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, për shkak të vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe shkëljes së dispozitave të procedurës kontestimore.
14. Më 7 tetor 2008, Gjykata e Qarkut nxori Aktgjykimin [Ac. nr. 267/2007], me të cilin e refuzoi ankesën e të paditurës si të pabazuar dhe e vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në tërësi.
15. Me qëllim të zbatimit të Aktgjykimit të Gjykatës Komunale, KEK-u vendosi të paguajë shumën e përgjithshme në një varg pagesash mujore për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh. Këto pagesa mujore u zhvilluan nga 1 korriku 2005 deri më 1 korrik 2010, kur përfundoi pagesa e shumës totale prej 42,000 euro të urdhëruar nga gjykatat e rregullta.
16. Më 3 shkurt 2010, parashtruesit e kërkesës paraqitën në Gjykatën Komunale në Prishtinë kërkesëpadinë e re kundër KEK-ut, duke kërkuar kompensimin e dëmit material, në mënyrë të veçantë, kompensimin e fitimit të humbur, në bazë të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve në fuqi në atë kohë (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, nr. 29/78 e ndryshuar). Parashtruesit e kërkesës konsideruan se *"në emër të fitimit të humbur e paditura ta paguajë kompensimin në këstet mujore duke pasur parasysh edhe shpenzimet që do t'i kishte i ndjeri po të ishte gjallë, në shumë prej 500 € në muaj, derisa të ekzistojnë kushtet ligjore për këtë"*.
17. KEK-u iu përgjigj pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, duke argumentuar se nuk ka legjitimitet pasiv në këtë rast, sepse njësitë e biznesit nën autoritetin e të cilëve ka ndodhur aksidenti janë privatizuar dhe tani janë pjesë e ndërmarrjes së re Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT), dhe se kërkesa e parashtruesve të kërkesës për shpërblimin e dëmit ka skaduar për shkak të parashkrimit, siç përcaktohet në nenin 376 të Ligjit mbi Marrëdhënien e Detyrimeve.
18. Më 29 dhjetor 2015, Gjykata Themelore nxori Aktgjykimin [C. nr. 241/10], me të cilin e miratoi kërkesëpadinë e parashtruesve të kërkesës si të bazuar. Gjykata Themelore i trajtoi pretendimet lidhur me legjitimitetin pasiv të

ngritura nga e paditura (KEK). Për sa i përket pretendimeve lidhur me afatet e parashkrimit, Gjykata Themelore, ndër të tjera, arsyetoi:

“Po ashtu pretendimi për vjetërsimin e kërkesës për kompensimin e dëmit në formë të rentës nga gjykata është vlerësuar si i pabazë meqë sipas dispozitës së nenit 373 par 3 të LMD parashihet se e drejta e ushqimit e përcaktuar me ligj nuk parashkruhet”.

19. E paditura (KEK) parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore [C. nr. 241/10], duke pretenduar zbatim të gabuar të ligjit, veçanërisht sa i përket legjitimitetit pasiv dhe skadimin e parashkrimit për kërkimin e kompensimit për dëmin e shkaktuar.
20. Më 17 qershor 2016, Gjykata e Apelit nxori Aktgjykimin [CA. nr. 1735/2016] me të cilin aprovoi ankesën e KEK-ut dhe e anuloi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore [C. nr. 241/10].
21. Gjykata e Apelit, mbi bazën e nenit 376 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, arsyetoi se pretendimet për kompensim për dëmin e shkaktuar parashkruhen pas 3 (tre) vjetëve pasi pala ka pësuar ose ka mësuar për dëmin. Ajo hodhi poshtë interpretimin e Gjykatës Themelore për zbatimin e nenit 373 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, sipas të cilit e drejta e ushqimit nuk mund të parashkruhet, sepse në arsyetimin e Gjykatës së Apelit, dhe në këtë rast konkret, çështja nuk ka të bëjë me të drejtën për ushqim, por kërkesë për shpërblimin e dëmit.
22. Parashtruesit e kërkesës parashtruan kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit [CA. nr. 1735/2016], duke pretenduar zbatimin e gabuar të dispozitave materiale të ligjit dhe faktin se gjykata e shkallës së dytë e kishte zbatuar nenin 376 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (kërkesë për shpërblim dëmi), dhe në fakt sipas parashtruesve të kërkesës është dashur ta zbatojë nenin 373 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (pretendimet për të drejtën në ushqim).
23. Më 25 tetor 2016, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin [Rev. nr. 248/2016], me të cilin e refuzoi kërkesën e parashtruesve të kërkesës për revizion si të pabazuar dhe e vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit me arsyetim të detajuar.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

24. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Aktgjykimi [Rev. nr. 248/16] i Gjykatës Supreme i 25 tetorit 2016, në lidhje me Aktgjykimin [CA nr. 1735/2016] e Gjykatës së Apelit të 23 majit 2016, kanë shkelur të drejtën e tyre për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe të drejtën e tyre për mbrojtje dhe përkujdesje të garantuar me nenin 50 [Të Drejtat e Fëmijës] të Kushtetutës.
25. Në lidhje me nenin 31 të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Gjykata Supreme dhe Gjykata e Apelit kanë shkelur të drejtën e tyre për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, për shkak të interpretimit qartazi të gabuar të Ligjit

mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, sa i përket afateve dhe aplikueshmërisë së parashkrimit.

26. Sa i përket nenit 50 të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se duke refuzuar kërkesat e tyre, Gjykata Supreme dhe Gjykata e Apelit kanë shkelur të drejtat e fëmijëve të të ndjerit për mbrojtjen dhe kujdesin e domosdoshëm për mirëqenien e tyre. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se varen nga pagesa e një rente për mbijetesën dhe mirëqenien e tyre të vazhdueshme.
27. Në fund, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata që ta deklarojë kërkesën e tyre të pranueshme dhe ta vërtetojë Aktgjykimin [C. nr. 241/10] e Gjykatës Themelore në Prishtinë të 29 dhjetorit 2015, duke shpallur Aktgjykimin [Rev. nr. 248/2016] të Gjykatës Supreme të 25 tetorit 2016 në lidhje me Aktgjykimin [Ac. nr. 1735/16] e Gjykatës së Apelit të 23 majit 2016, të pavlefshëm.

Pranueshmëria e kërkesës

28. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i përmbush kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
29. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton se:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

30. Në vazhdim, Gjykata vlerëson nëse parashtruesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç specifikohet më tej në Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 48 [Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49 [Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

31. Lidhur me plotësimin e këtyre kritereve, Gjykata konstaton se parashtruesit e dorëzuan kërkesën në cilësinë e palës së autorizuar, duke kontestuar një akt të autoritetit publik, përkatësisht Aktgjykimin [Rev. nr. 248/2016] e Gjykatës Supreme të 25 tetorit 2016, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesit e kërkesës kanë sqaruar gjithashtu të drejtat dhe liritë që pretendojnë se u janë shkelur, sipas kërkesave të nenit 48 të Ligjit dhe kanë dorëzuar kërkesën në përputhje me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
32. Megjithatë, Gjykata duhet të vlerësojë më tej nëse janë plotësuar kriteret e parapara në rregullin 36 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 36, paragrafët (1) (d) dhe (2) (d) të Rregullores së punës, përcakton që:

“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

33. Gjykata rikujton se procedura e ndjekur nga parashtruesit e kërkesës ka të bëjë me kërkesën për shpërblim për dëmin e shkaktuar, kundër të paditurës (KEK), si kompensim për vdekjen e bashkëshortit dhe babait të parashtruesve të kërkesës më 8 maj 2005. Kontesti përfundoi me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [Rev. nr. 248/2016] të 25 tetorit 2016, të cilin parashtruesit e kërkesës e kontestojnë në Gjykatë, duke pretenduar shkeljen e të drejtave të tyre të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 50 [Të Drejtat e Fëmijës] të Kushtetutës, sepse Gjykata Supreme ka interpretuar në mënyrë qartazi të gabuar Ligjin mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve. Parashtruesit e kërkesës argumentojnë se në rrethanat e rastit të tyre konkret, zbatohet neni 373, i cili përcakton që e drejta për ushqim nuk i nënshtrohet parashkrimit, në vend të nenit 376 i cili rregullon kërkesat për shpërblimin e dëmit të shkaktuar. Sipas parashtruesve të kërkesës, në qoftë se do të ishin zbatuar dispozitat e sakta të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, kërkesat e tyre do të ishin miratuar.
34. Gjykata fillimisht vëren se në grupin e parë të procedurave kundër KEK-ut, parashtruesit e kërkesës kërkuan vetëm kompensim për “*dhimbjen e pësuar shpirtërore*” si pasojë e vdekjes së bashkëshortit dhe babait të tyre. Gjykata Komunale u përcaktoi parashtruesve të kërkesës një shumë në kompensim, i cili gjithashtu u vërtetua nga Gjykata e Qarkut në Aktgjykimin e saj [Ac. nr. 267/2007] të 7 tetorit 2008. KEK-u ka përmbushur detyrimet që rrjedhin nga ky Aktgjykim.

35. Më pas, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës iniciuan kërkesëpadi të re në Gjykatën Komunale më 3 shkurt 2010, duke filluar kështu grupin e dytë të procedurave gjyqësore. Në kërkesëpadinë të re, parashtruesit e kërkesës kërkuan vazhdimin e pagesës së një rente mujore, që ishte aprovuar me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale dhe anuluar me Aktgjykimet e Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme. Parashtruesit e kërkesës argumentuar se nëse dispozitat e Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve që ndërlidhen me parashkrimin do të ishin zbatuar në mënyrë të drejtë, do të ishte vërtetuar Aktgjykimi fillestar i Gjykatës Komunale.
36. Në lidhje me këtë, Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës i bazojnë pretendimet e tyre në interpretimin qartazi të gabuar të dispozitave të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, që pretendohet të jetë bërë nga Gjykata Supreme. Gjykata rikujton se ky pretendim ka të bëjë me fushën e ligjshmërisë dhe si i tillë, nuk është në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese dhe për këtë arsye, në parim, Gjykata nuk mund ta shqyrtojë atë.
37. Gjykata përsërit se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmëria), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “shkallës së katërt”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t’i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. (Shih, rasti *García Ruiz kundër Spanjës*, GJEDNJ nr. 30544/96, i 21 janarit 1999, par. 28 dhe shih, gjithashtu rastin: KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
38. Ky qëndrim është mbajtur vazhdimisht nga Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ), që në mënyrë të qartë thekson se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale. (shih, GJEDNJ-së, *Pronina kundër Rusisë*, Vendimi për pranueshmëri, të 30 qershorit 2005, kërkesa nr. 65167/01).
39. Gjykata, megjithatë, thekson se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së gjithashtu përcakton rrethanat nën të cilat mund të bëhen përjashtime nga ky qëndrim. Në rastin *Angjelković kundër Serbisë* (Aktgjykimi i 9 prillit 2013, nr. 1401/08, paragrafi 24), GJEDNJ përsëriti se nuk do të vë në dyshim interpretimin e ligjit nga gjykatat, përveç nëse është dukshëm arbitrar ose vendimet e atyre gjykatave janë arbitrare apo në ndonjë mënyrë qartazi të paarsyeshme. Në këtë rast, GJEDNJ pohon:

“Gjykata në fillim, rikujton se detyra e saj nuk është ta merr rolin e gjykatave vendase. Para së gjithash, autoritetet vendase, në veçanti gjykatat, duhet t’i zgjidhin problemet e interpretimit të legjisllacionit vendor (shih, në mesin e autoriteteve tjera, Brualla Gómez de la Torre

kundër Spanjës, të 19 dhjetorit 1997, paragrafi 31, Raport i aktgjykimeve dhe vendimeve 1997-VIII). Në këtë rast, Gjykata nuk do të ngrejë çështje të interpretimit të ligjit vendor nga gjykatat vendase, përveç rasteve të arbitraritetit të dukshëm (shih, mutatis mutandis, Adamsons kundër Letonisë, nr. 3669/03, paragrafi 118, 24 qershor 2008), me fjalë të tjera, kur vëren se zbatimi i ligjit nga gjykatat vendase në raste të caktuara ishte qartazi i gabuar ose ishin marrë konkluzione arbitrare dhe/ose ishte mohuar drejtësia (shih, mutatis mutandis, Farbers dhe Harlanova kundër Lituanisë (vendimi), numër 57313/00, 6 shtator 2001, dhe megjithëse në kontekstin e nenit 1 të Protokollit 1, Beyeler kundër Italisë [DHM], numër 33202/96, paragrafi 108, GJEDNJ 2000-I).

40. GJEDNJ përsëriti këtë qëndrim duke theksuar se “edhe pse kryesisht autoritetet kombëtare, sidomos gjykatat, duhet të zgjidhin problemet e interpretimit të legjislacionit të brendshëm, roli i Gjykatës është të verifikojë nëse efektet e interpretimit të tillë janë në përputhje me Konventën”. (shih, mutatis mutandis, Miragall Escolano dhe të tjerët kundër Spanjës, nr. 38366/97, paragrafët 33-39, GJEDNJ 2000-I). “Prandaj, megjithëse ka vetëm fuqi të kufizuar për të shqyrtuar pajtueshmërinë me ligjin vendas, Gjykata mund të nxjerrë konkluzione përkatëse sipas Konventës, kur vëren se gjykatat e vendit kanë zbatuar ligjin në një rast të caktuar qartazi në mënyrë të gabuar ose në mënyrë që të arrijnë përfundime arbitrare”. (Shih: Aktgjykimin e lartcekur Anheuser-Busch Inc., paragrafi 83; Kuznetsov dhe të tjerët kundër Rusisë, nr. 184/02, paragrafët 70-74 dhe 84, 11 janar 2007; Päduraru kundër Rumanisë, nr. 63252/00, paragrafi 98, GJEDNJ 2005 - (ekstrakte), Sovtransavto Holding kundër Ukrainës, nr. 48F553 /99, paragrafët 79, 97 dhe 98, GJEDNJ 2002-VII, Beyeler kundër Italisë [GC], nr. 33202 96, paragrafi 108, GJEDNJ 2000-I, dhe, mutatis mutandis, Cirlis dhe Kouloumpas kundër Greqisë, aktgjykimi i 29 majit 1997, Raportet e aktgjykimeve dhe vendimeve 1997-III, paragrafët 59-63. Shih gjithashtu rastin e GJEDNJ-së Koshoglu kundër Bullgarisë, Kërkesa nr. 48191/99, Aktgjykimi i 10 majit 2007, paragrafi 50).
41. Rrjedhimisht, në pajtim me praktikën gjyqësore të Gjykatës dhe praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, është detyrë e gjykatave të rregullta që t'i vlerësojnë faktet dhe provat të cilat i kanë administruar. (shih Arsyetimin e GJEDNJ-së, Thomas kundër Mbretërisë së Bashkuar, të 10 majit 2005, kërkesa nr. 19354/02). Detyra e Gjykatës Kushtetuese është që të shqyrtojë nëse ka ndodhur shkelja e të drejtave kushtetuese (e drejta për gjykim të drejtë, e drejta për qasje në gjykatë, e drejta për mjete efektive juridike, etj.), si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë, eventualisht, arbitrar ose diskriminues. (Shih, për shembull, rastet e GJEDNJ-së Koshoglu kundër Bullgarisë, Aktgjykimi i 10 majit 2007, nr. 48191/99, Anheuser-Busch Inc. kundër Portugalisë, Aktgjykimi i 11 janarit 2007, nr. 73049/01, Kuznetsov dhe të tjerët kundër Rusisë i 11 janarit 2007, nr. 184/02, Khamidov kundër Rusisë, Aktgjykimi i 15 nëntorit 2007, nr. 72118/01, Angjelković kundër Serbisë, Aktgjykim i 9 prillit 2013, nr. 1401/08, Dulaurens kundër Francës, Aktgjykimi i 21 marsit 2000, nr. 34553/97).
42. Në rastin konkret, parashtuesit e kërkesës argumentojnë se gjykatat e rregullta kanë interpretuar qartazi në mënyrë të gabuar dhe në mënyrë

arbitrare ligjin. Megjithatë, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit dhe më pas Gjykata Supreme shqyrtuan pretendimet themelore të parashtruesve të kërkesës, dhe i adresuan e i arsyetuan pretendimet lidhur me interpretimin dhe aplikueshmërinë e dispozitave përkatëse të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve në këtë rast konkret.

43. Lidhur me këtë, Gjykata e Apelit konstatoi se në bazë të nenit 376 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve është paraparë që kërkesa e shpërblimit të dëmit të shkaktuar parashkruhet për tre vjet nga data kur i dëmtuari ka mësuar për dëmin. Gjykata e Apelit konstatoi se parashtruesit e kërkesës mësuan për dëmin në ditën kur kishte vdekur bashkëshorti dhe babai i tyre, përkatësisht më 5 maj 2005, ndërsa ata nuk parashtruan kërkesëpadinë e tyre të re deri më 3 shkurt 2010. Si rezultat i kësaj, Gjykata e Apelit arriti në përfundim se kërkesa e re për shpërblimin e dëmit ishte jashtë afatit të parashkrimit.
44. Gjykata gjithashtu, vëren se edhe Gjykata Supreme ka analizuar pretendimin e parashtruesve të kërkesës në revizion dhe konkludoi se afati i parashkrimit fillon të rrjedhë nga data kur paditësi ka mësuar për dëmin. Në këtë rast, nuk është fakt i kontestueshëm kur parashtruesit e kërkesës kanë mësuar për dëmin, dhe duke marrë parasysh datën e paraqitjes së kërkesëpadisë, që është 3 shkurt 2010, Gjykata Supreme, mbi bazën e nenit 376 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, konkludoi se kërkesëpadia është parashkruar. Përveç kësaj, Gjykata Supreme gjithashtu arsyetoi pse nuk janë të aplikueshme argumentet e parashtruesve të kërkesës për zbatimin e nenit 373 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve dhe dallimin ndërmjet të drejtës për ushqim dhe të drejtës për kompensim të dëmit. Gjykata Supreme, ndër të tjera, arsyetoi:

“Duke u nisur nga gjendja e vërtetuar faktike, gjykata e revizionit gjen se përfundimi i gjykatës së shkallës së dytë është i drejtë, duke u nisur nga fakti se aksidenti ka ndodhur më 24.3.2005, ndërsa vdekja e tij ka ndodhur më 08.5.2005, padia në gjykatë është parashtruar më 3.2.2010 dhe atë pas afatit të përcaktuar nga neni 376 të LMD-së ku është përcaktuar se kërkesa për shpërblimin e dëmit parashkruhet për 3 vjet, nga data kur i dëmtuari ka marrë dijeni për dëmin dhe personin i cili e ka shkaktuar dëmin. Paditësit në padi konsiderohet se kanë marrë dijeni për dëmin dhe personin nga data kur është shkaktuar aksidenti. Në këtë kontest nuk ka vend të zbatimit të nenit 373 par. 1 të LMD-së dhe se kundërshtimi i parashkrimit duhet të vlerësohet në bazë të nenit 376 të LMD-së, pasi që kemi të bëjmë për kërkesën për shpërblim material në formë të rentës, rentës në të holla, e cila nuk është kërkesë sipas nenit 373 par. 3 pasi që mbajtja ligjore nënkupton detyrimet të vërtetuara me ligj siç është ushqimi i fëmijëve të rritur nga ana e prindërve, mbajtja e prindërve nga ana e fëmijëve, mbajtja në mes të bashkëshortëve dhe të afërmve, ndërsa kërkesa për rentë është në formë të shpërblimit material dhe se llogaritja e parashkrimit të kërkesës bëhet në bazë të nenit 376 të LMD-së“.

45. Duke pasur parasysh atë që u tha, Gjykata konsideron se në rastin konkret nuk ekzistojnë elementet e interpretimit të palogjikshëm, si dhe zbatimit të gabuar dhe arbitrar të ligjit, sepse janë zbatuar dispozitat relevante të ligjit në fuqi, dhe gjykatat e rregullta kanë dhënë arsye të qarta dhe të plota për vendimet e tyre.

46. Përveç kësaj, Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës nuk kanë treguar dhe dëshmuar se procedurat në Gjykatën Supreme kanë qenë të padrejta apo arbitrare, apo që të drejtat dhe liritë themelore të tyre të mbrojtura me Kushtetutë janë shkelur si rrjedhojë e pretendimeve për interpretimin e gabuar të neneve konkrete të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Asnjë çështje kushtetuese nuk është dëshmuar nga parashtruesit e kërkesës. (Shih, rasti KI63/16, parashtrues i kërkesës *Astrit Pira*, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 gushtit 2016, para. 44. dhe shih, gjithashtu rastin KI150/15; KI161/15; KI162/15; KI14/16; KI19/16; KI60/16 dhe KI64/16, parashtrues të kërkesës *Arben Gjukaj, Hysni Hoxha, Driton Pruthi, Milazim Lushtaku, Esat Tahiri, Azem Duraku dhe Sami Lushtaku*, Aktvendim për papranueshmëri, i 15 nëntorit 2016, para. 62).
47. Rrjedhimisht, Gjykata është e mendimit se nuk ka pasur shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës.
48. Gjykata rikujton që parashtruesit e kërkesës gjithashtu pohojnë se duke refuzuar kërkesën e tyre për shpërblimin e dëmit, gjykatat e rregullta kanë shkelur të drejtën për mbrojtjen dhe kujdesin e fëmijëve, të garantuar me nenin 50 (1) të Kushtetutës. Parashtruesit e kërkesës e bazojnë këtë pretendim në faktin se ata morën një pagesë mujore nga KEK-u ndërmjet 1 korrikut 2005 dhe 1 korrikut 2010, dhe ata kishin kërkuar nga gjykatat që ta urdhërojnë KEK-un që të vazhdojë të paguajë një rentë mujore pas kësaj date.
49. Gjykata vëren se pagesat mujore që parashtruesit e kërkesës morën nga KEK-u ishin si rezultat i një shpërblimi për kompensim për "*dhimbjet e pësuaras shpirtërore*" për shkak të vdekjes së bashkëshortit dhe babait të parashtruesve të kërkesës. Gjykata vëren se gjykatat e rregullta kanë përcaktuar një shumë kompenzimi për parashtruesit e kërkesës, të cilën pala e paditur (KEK), e ka paguar në formë të një rente mujore. Rrjedhimisht, Gjykata vëren se këto pagesa mujore nuk janë përcaktuar si pagesa për mbrojtjen dhe kujdesin e fëmijëve.
50. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës nuk kanë argumentuar se si pala e paditur (KEK) kishte ndonjë detyrim tjetër ligjor për të siguruar mbrojtjen dhe kujdesin e fëmijëve të të ndjerit. Parashtruesit e kërkesës në mbështetje të pretendimeve të tyre kryesisht argumentojnë se gjykatat e rregullta kanë interpretuar në mënyrë qartazi të gabuar dispozitat e ligjit për sa i përket parashkrimit të kërkesës së tyre për vazhdimin e pagesës së një rente, argument ky që tashmë është adresuar në këtë Aktvendim. Pretendimet e parashtruesve të kërkesës se e drejta e tyre për mbrojtje dhe kujdes të domosdoshëm për mirëqenien e tyre ishte shkelur me vendimet e kontestuara të gjykatave të rregullta nuk janë dëshmuar më tej me ndonjë argument shtesë.
51. Duke konstatuar se nuk ka pasur shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm në interpretimin e ligjit nga gjykatat e rregullta, Gjykata konsideron se pretendimi i parashtruesve të kërkesës se ata kishin të drejtë në vazhdimin e pagesës së një rente mujore për mbrojtjen dhe kujdesin e fëmijëve të mitur nuk arrin nivelin e shkeljes kushtetuese.

52. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës nuk i kanë dëshmuar pretendimet e tyre, dhe as nuk kanë paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* që do të tregonte shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: Konventa). (shih rastin nr. KI19/14 dhe KI21/14, parashtrues *Tafil Qorri dhe Mehdi Syla*, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 2129/2013, të 5 dhjetorit 2013 dhe Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 1947/2013, të 5 dhjetorit 2013).
53. Si përmbledhje, Gjykata vlerëson se në Aktgjykimin e kontestuar nuk ka fakte apo rrethana që do të tregonin në ndonjë mënyrë se në procedurat në gjykatat e rregullta, parashtruesve të kërkesës u janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë ose me Konventa.
54. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 36, paragrafët (1) (d) dhe (2) (d) të Rregullores së punës.

Kërkesa për moszbulimin e identitetit

55. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës kërkuan moszbulimin e identitetit të tyre publikisht, *“për shkak të arsyes se emri im është i parëndësishëm në shqyrtimin e rastit dhe publiciteti mund të ndikojë në mënyrë indirekte tek fëmijët e mi”*.
56. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet rregullit 29 (6) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

“Pala që parashtron kërkesë mund të kërkojë që identiteti i tij ose i saj të mos zbulohet publikisht dhe të paraqesë arsyet për këtë kërkesë. Gjykata mund të aprovojë kërkesën nëse vërteton se arsyet janë të bazuara mirë”.
57. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 8 (1) të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, që përcakton:

“Shtetet palë marrin përsipër respektimin e të drejtës së fëmijës për të ruajtur identitetin e tij, duke përfshirë këtu shtetësinë, emrin dhe lidhjet familjare që njihen me ligj pa ndonjë ndërhyrje të paligjshme”.
58. Gjykata konsideron se në një rast familjar publiciteti mund, madje edhe në mënyrë indirekte, të ndikojë në identitetin, emrin dhe marrëdhëniet familjare të fëmijëve.
59. Prandaj, në pajtim me nenin 8 (1) të Konventës për të Drejtat e Fëmijës dhe rregullin 29 (6) të Rregullores së punës, Gjykata e miraton si të bazuar kërkesën e parashtruesve të kërkesës për moszbulimin e identitetit të tyre publikisht.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113, paragrafi 7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (d) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 23 tetor 2017, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese


Gresa Caka-Nimani

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Arta Rama-Hajrizi

